



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 35, datë 29.12.2020

**PËR SHPALLJEN E VENDIT VAKANT PËR PROCEDURËN E TRANSFERIMIT
NËPËRMJET LEVIZJES PARALELE NË PROKURORITË E JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 43 pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, gërma “a” të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 5 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” miratuar me Vendimin nr.261, datë 17.11.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e pozicionit si më poshtë :

Pozicioni vakant numër 1 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës

2. Subjektet të cilët kanë të drejtë të kandidojnë, kriteret që duhet të plotësojnë, afati i dorëzimit të shprehjes së interesit, dokumentacioni që duhet të dorëzojnë dhe adresa ku do të dorëzohet shprehja e interesit, do të njoftohet në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

